



**NGACMIMI
SEKSUAL
DËN OHET
ME LIGJ.**

Ngacmimi Seksual në Universitet të Prishtinës

Kjo broshurë është krijuar nga **Qendra për Art dhe Komunitet – Artpolis**, në kuadër të projektit **“HumanRightivism”** implementuar nga **Fondi për Zhvillim Komunitar – CDF**, përkrahur nga **Ambasada e Suedisë** në Prishtinë.

Realizimi i këtij materiali është financuar nga **Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Zhvillim (Sida)**. Përgjegjësia për përmbajtjen i takon tërësisht autorit. Sida nuk ndan domosdoshmërisht pikëpamjet dhe interpretimet e shprehura.

Përgatitur nga **Diellza Bezera** me kontribut të **Qëndresa Hyseni** dhe **Valëza Sijarina**
Redaktuar nga **Vjollca Krasniqi**

Prishtinë

Tetor, 2022

Çka është ngacmimi seksual?

Definicioni sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës:

Ngacmimi seksual nënkupton cilëndo formë të sjelljes së padëshiruar verbale, joverbale ose fizike të natyrës seksuale, me qëllim të cenimit të dinjitetit apo që cenon dinjitetin e personit, dhe krijon një mjedis i cili është objektivisht frikësues, armiqësor, degradues ose poshtërues.ⁱ

Format e **Ngacmimit Seksual**

Ngacmim gjinor (më i zakonshmi)

Deklarata seksuale të përgjithësuara dhe sjellje që përcjellin qëndrime fyese ose poshtëruese për gratë ose burrat. Shembuj: vërejtje fyese, shaka të turpshme ose humor rreth seksit, etj.

Sjellje joshëse

Sjellje seksuale të padëshiruara, të papërshtatshme dhe fyese. Shembuj përfshijnë ftesën seksuale të përsëritur dhe të padëshiruar; kërkesa këmbëngulëse për takime / darkë / pije; letra të vazhdueshme, thirrje telefonike, etj.

Kërkesë seksuale

Kërkimi i aktivitetit seksual ose sjelljeve të tjera të lidhura me seksin duke premtuar shpërblim; propozimi mund të jetë ose i drejt për drejt ose i imponuar.

Kërcënim seksual

Shtrëngim i aktivitetit seksual ose sjellje tjetër e lidhur me seksin me anë të kërcënimit të dënimit; shembujt përfshijnë vlerësime negative të performancës, pengimin në dhënien e promovimit, kërcënimin për mos përfshirje në provim.

Imponim seksual

Detyrim seksual (siç është prekja me forcë, ndjenja, kapja) ose sulmi seksual. (Burimi: Shoqata Psikologjike Amerikane)ⁱⁱ

Sjelljet të cilat konsiderohen **ngacmim seksual** mund të jenë të natyrës

(por nuk kufizohen vetëm me)



Verbale



Joverbale



Fizike



Vizuele

Sjelljet të padëshiruara
verbale



- > Komentimi me përmbajtje seksuale ndaj trupit, apo dukjes fizike të personit
- > Thirrja në emra ledhatues
- > Tregimi i barcoletave me përmbajtje seksuale
- > Kthimi i temës së punës në tema me natyrë seksuale
- > Parashtrimi i pyetjeve për jetën personale, për lidhjet dhe jetën intime
- > Përhapja e thashethemeve për jetën seksuale të personit
- > Kërkimi për takime jashtë vendit të punës

Sjelljet të padëshiruara
jo verbale



- > Shiqimi i personit nga lart poshtë
- > Shiqimi ngultas në sy apo shkelja e syrit
- > Pengimi i rrugës së personit
- > Ndjekja pas/përcjellja
- > Ofrimi i dhuratave personale
- > Gjeste me karakter seksual, mimikë, duar apo lëvizje trupore
- > Fishkëllima

Sjelljet të padëshiruara
fizike



- > Prekja apo bërja masazh rreth qafës dhe krahëve
- > Prekja e rrobave, flokëve apo trupit
- > Përqafimi, shtrëngimi i duarve (pa dëshirë),

- > Prekja, pickimi apo fërkimi me trup
- > Qëndrimi afër apo largimi i gjërave nga trupi

Sjelljet të padëshiruara
vizuele



- > Dërgimi i fotove dhe videove me përmbajte seksuale
- > Dërgimi i mesazheve apo letrave me përmbajte seksuale

- > Prezantimi i materialeve me përmbajte seksuale

Rregullorja për parandalimin dhe mbrojtjen nga ngacmimi seksual apo ngacmimi në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”

Rregullorja për parandalimin dhe mbrojtjen nga ngacmimi seksual apo ngacmimi në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina” ka hyrë në fuqi me datë 11.05.2021. Kjo rregullore ka për qëllim ruajtjen dhe promovimin e standardeve më të larta të mësimdhënies, mësimnxënies dhe krijimit të një ambienti të sigurt dhe të lirë nga diskriminimi për studentët, personelin akademik, joakademik dhe administrativ, po ashtu afirmimin e të drejtave të individëve në vendin e punës dhe në ambiente arsimore.

Fushëveprimi i Rregullores

Dispozitat e përgjithshme

Neni 1. – Fushëveprimi

Kjo rregullore zbatohet për të gjithë personelin akademik, joakademik dhe administrativ të punësuar në Universitetin e Prishtinës, pavarësisht nga forma dhe lloji i kontratës apo niveli i emërimit duke përfshirë por pa u kufizuar në profesor asistent, profesor i asociuar, profesor i rregullt, asistent, lektor, profesor vizitues, referent si dhe të punësuarit apo të angazhuarit tjerë në Universitetin e Prishtinës, si dhe studentët e Universitetit të Prishtinës.

Çfarë përgjegjësisish dhe obligimesh ka Universiteti i Prishtinës sipas Rregullores?

Përgjegjësitë e Universitetit të Prishtinës për parandalimin dhe mbrojtjen nga ngacmimi dhe ngacmimi seksual – Neni 5.

Neni 5.3

Universiteti ndërmerr masa parandaluese që të informojë, edukojë dhe komunikojë me studentët, personelin akademik, joakademik dhe administrativ në lidhje me parandalimin dhe sanksionimin e ngacmimit seksual në vendin e punës dhe ambientet arsimore.

Neni 6.3

Rektorati dhe njësitë akademike obligohen t'iu ofrojnë qasje të lehtë studentëve, personelit akademik, joakademik dhe administrativ, në informata dhe aktet ligjore dhe nënligjore, të cilat e trajtojnë ngacmimin dhe ngacmimin seksual.

Zhvillimi dhe hartimi i planeve për parandalimin e rasteve të ngacmimit dhe ngacmimit seksual, shpërndarja e informatave dhe mënyrave të raportimit formal dhe joformal për ngacmimin dhe ngacmimin seksual sipas kësaj rregullore janë përgjegjësi e Universitetit të Prishtinës.

Si dhe ku të raportojmë ngacmimin dhe ngacmimin seksual?

Zyrtari për implementim të politikave për mbrojtje nga ngacmimi dhe ngacmimi seksual – Neni 7

Raportimi i ngacmimit dhe ngacmimit seksual sipas rregullores bëhet përmes Zyrtarit/es për implementimin e politikave për mbrojtjen nga ngacmimi dhe ngacmimi seksual. **Neni 7.1** obligon Universitetin e Prishtinës të emërojë një zyrtarë për implementimin e politikave për mbrojtjen nga ngacmimi dhe ngacmimi seksual që do të jetë përgjegjës për informimin, këshillimin dhe pranimin e denoncimeve për ngacmim dhe ngacmim seksual në Universitetin e Prishtinës.

Këshilli Drejtues i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" në mbledhjen e mbajtur me datë 15.12.2021 ka emëruar zyrtaren **Drita Hyseni** për implementimin e politikave për mbrojtje nga ngacmimi dhe ngacmimi seksual.

Studentët të cilët vërejnë sjellje të cilat janë në mospërputhje me rregulloren, kanë të drejtën e denoncimit/raportimit tek zyrtarja Drita Hyseni. Raportimi tek zyrtarja Drita Hyseni mund të bëhet në dy forma:

- Përmes postës elektronike (email): **raporto.rastin@uni-pr.edu**
- Përmes formës fizike mund të bëhet në **objektin e Rektoratit të UP-së në zyrën nr.22.**

Paraqitja e denoncimit për ngacmim ose ngacmim seksual – **Neni 9**

Raportimi joformal sipas **nënit 9.2.** nënkupton denoncimin që subjekti mund ta bëjë kur ai/ajo nuk është i/e sigurtë në lidhje me atë nëse dëshiron të bëjë edhe denoncimin formal. Denoncimet joformale mund të jenë verbale dhe me shkrim (në kopje fizike ose përmes postës elektronike në email në adresën zyrtare të zyrtarit për mbrojtje nga ngacmimi seksual). Në rast të denoncimit joformal verbal, denoncimi duhet të evidentohet nga zyrtari për mbrojtje nga ngacmimi. Asnjë veprim nuk do të ndërmerret nga zyrtari për mbrojtje nga ngacmimi, përveç në rastet kur nga denoncimi joformal, zyrtari për mbrojtje nga ngacmimi e vlerëson se subjekti raportues mund të jetë në rrezik immanent. Në këtë rast, zyrtari për mbrojtje nga ngacmimi mund të denoncojë rastin te Këshilli i Etikës së Universitetit të Prishtinës dhe

për këtë duhet ta njoftojë paraprakisht subjektin raportues.

Ndërsa denoncimi formal i ngacmimit dhe ngacmimit seksual sipas **nënit 9.5.** duhet të jetë i qartë, mund ta identifikojë subjektin raportues dhe subjektin e dyshuar dhe duhet ta shpjegojë sjelljen e subjektit të dyshuar, për të cilën paraqitet denoncimi, efektin e sjelljes të subjektit raportues dhe duhet të përfshijë datat dhe informatat tjera në lidhje me rastin. Në qoftë se ka dëshmitarë apo dëshmi shtesë, ato duhet t'i bashkëngjiten denoncimit.

Neni 9.5. Subjekti raportues mund të paraqes denoncim për ngacmim ose ngacmim seksual sipas kësaj rregulloreje, jo më vonë se një (1) vit nga dita e ndodhjes së shkeljes.

Çka ndodhë pas denoncimit/raportimit?

Pas denoncimi sipas **nenit 9.6** zyrtari për mbrojtje nga ngacmimi e protokollon rastin e denoncuar (formal dhe joformal) në regjistra të veçantë të raportimeve fizike dhe/apo online për ngacmime seksuale dhe i mban dosjet e raportimeve fizike dhe/apo online në një vend të sigurtë.

Neni 11 – Procedura disiplinore

Neni 11.2. Barra e provës në procedurën e shqyrtimit të denoncimit për ngacmim ose ngacmim seksual bie mbi palët procedurale, sipas parimit të barazisë së palëve (denoncuesi/ja i ofron provat, ndërsa të denoncuarit/es i jepet mundësia e mbrojtjes).

Sipas **nenit 11.2** Këshilli i Etikës duhet ta ftoj për intervistë denoncuesin/en jo më vonë se pesë (5) ditë kalendarike pas pranimit të denoncimit formal për ngacmim ose ngacmim seksual, duke u siguruar që subjekti i dyshuar është njoftuar dy (2) ditë më herët.

Cilat janë masat ndëshkuese?

Neni 12 – Masat për shkeljet disiplinore

Neni 12.1.2. Për personelin akademik, joakademik dhe administrative;

- a)** Paralajmërim për suspendim/ndërprerje të marrëdhënies së punës;
- b)** Suspendim i përkohshëm pa pagesë;
- c)** Ndërprerje e marrëdhënies së punës.

Neni 12.1.1. Për studentët;

- a)** Paralajmërim për suspendim/përgjithmonë;
- b)** Suspendim nga fakulteti për një (1) vit;
- c)** Përgjithmonë nga fakulteti përgjithmonë.

Neni 3.2 Në marrjen e vendimeve dhe masave disiplinore në procedurën për shqyrtimin e denoncimeve për ngacmim apo ngacmim seksual, Këshilli i Etikës zbaton këtë rregullore, Statutin e Universitetit të Prishtinës, Ligjin për Arsim të Lartë, Ligjin për Mbrojtje nga Diskriminimi, Ligjin për Barazi Gjinore, Ligjin e Punës dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore të zbatueshme.^{iv}

Referencat

- I Kodi Penal i Republikës së Kosovës:
<https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/6A2D4377-6AE1-4530-909F-3FB2680CD1EC.pdf>
- II <https://www.usf.edu/student-affairs/victim-advocacy/types-of-crimes/sexualharassment.pdf>
- III Punimi “Ngacmimet Seksuale në Kosovë – Emirëjeta Kumnova- Psikologe
- IV Rregullorja për parandalimin dhe mbrojtjen nga ngacmimi seksual apo ngacmimi në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”: <https://dokumente.uni-pr.edu/> (Numri aktit: 752)

RAPORTO RASTIN

raporto.rastin@uni-pr.edu

Në **zyrën nr.22** në objektin e Rektoratit të Universitetit të Prishtinës tek zyrtarja për implementimin e politikave për mbrojtje nga ngacmimi dhe ngacmimi seksual, Drita Hyseni.



Sweden
Sverige

